



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Legjislatura e III-të

Nr. 35/08

Prishtinë, më 9.12.2008, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komisionit për Buxhet dhe Financa

Anëtarët e pranishëm të Komisionit: Haki Shatri, Kosara Nikolić, Besa Gaxherri, Safete Hadërgjonaj, Myrvete Pantina, Müfera Şinik, Xhevdet Neziraj, Riza Smaka, Hajdin Abazi, Naser Osmani.

Anëtarët jo të pranishëm: Gani Koci, Shkumbin Demaliaj.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Tisma-Prica, Vilson Ukaj, Dashurije Canolli.

Gjithashtu të pranishëm ishin: Agim Krasniqi Drejtor i Buxhetit në MEF, Behxhet Haliti nga MEF-i, përfaqësues të organizatave buxhetore të ftuara për në mbledhje, Teki Shala nga NDI, monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI.

Kryesues: Haki Shatri, nënkryetari parë i Komisionit

Rendi i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi, hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendit ditës miratohet pa ndryshime.

2. Shqyrtimi i Projektligjit (pjesa tekstuale) nr. L-105 për Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe autorizimin e shpenzimeve për periudhën 1 janar deri më 31 dhjetor 2009

Kryesuesi, propozoi që të analizohet secili nen dhe të shikohet mundësia e dhënies së propozimeve për ndryshimet eventuale të tyre.

Riza Smaka, propozoi që të riformulohet preambula, të thuhet Kuvendi i Republikës së Kosovës bazuar në nenin 65 pika (1) dhe (5) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës miraton Ligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2009. Njëkohësisht propozoi që të bëhet harmonizimi i testit në tri gjuhë. Propozimi i z. Smaka u përkrah që të bëhet amendament.

Naser Osmani, propozoi që të fshihet termi “konsoliduar”.

Kryesuesi, përkrahu propozimin e z. Osmani dhe kërkoi që të bëhet amendament me të cilin do të fshihej fjala i konsoliduar në tërë testin. Gjithashtu propozoi që përkufizimi “ndarje buxhetore” me amendament të zëvendësohet me termin “Buxheti i Republikës së Kosovës”.

Besa Gaxherri, kërkoi të shikohet mundësia e ndryshimit të termit “fitimet e bartura” sepse definimi nuk është mirë i përcaktuar. Gjithashtu kërkoi sqarime lidhur me termin “fondi i mirëbesimit”.

Agim Krasniqi, duke iu përgjigjur kërkesave për sqarim të termit “fondi i mirëbesimit”, theksoi se është fjala për fondin që mund të ndahen në bazë të një marrëveshje, si shembull mori rasti e ndarjes së mjeteve për punëtorët e arsimit. Ndërsa për termin “fitimet e mbajtura” do të shikohet mundësia e ndryshimit me ndonjë term më adekuat.

Haki Shatri, propozoi që në nenin 3 me amendament termi “paraparë” të zëvendësohet me termin “përcaktuar”. Gjithashtu neni 4, në fund të fjalisë të ndërrohet vendi i fjalës “neni 31” dhe të vendoset para shkurtesës LMFP.

Në nenin 5 u propozua të krijohet një nënpikë 2.4, tekstin e së cilës do ta formulojnë përfaqësuesit e MEF-it mëpastaj do të diskutohet në Komision.

U diskutua rreth nenit 6, paragrafi 3 që ka të bëjë me pavarësinë financiare të agjencioneve të pavarura.

Agim Krasniqi, theksoi se në nenin 6.3 bëhet fjalë për agjencionet e pavarura që janë përgjegjësi e Kuvendit. Qëllimi ka qenë që të vendosen si pjesë e rregullt e buxhetit për arsye se edhe këto marrin të hyra publike.

Besa Gaxherri, u pajtua që ato të jenë pjesë e buxhetit, por se ministri nuk duhet të ketë drejtë të caktoj buxhetin atyre, por kjo duhet bërë me rekomandim të komisionit dhe me vendim të Kuvendit.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, theksoi se gjatë diskutimi lidhur me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi është menduar që këtyre agjencioneve të pavarura mos t’iu cenohet pavarësia e veprimit, por duhet të përcaktohet shkalla e saj, duke ditur kërkesat megalomane që kanë këto agjencione.

Riza Smaka, u pajtua me propozimin e ministrit. Nuk ka asnjë agjencion plotësisht të pavarur. Duhet të jemi të kujdesëm ndaj këtyre agjencioneve dhe kërkesave të tyre të mëdha.

Hajdin Abazi, duke u ndërlidhur në diskutimin, theksoi se është çështje e ndjeshme veprimi agjencioneve të pavarura. U pajtua me mendimin e parafolësit se pavarësia funksionale nuk duhet cenuar, por se për pavarësinë financiare duhet vendos Komisioni me rekomandim, e mëpastaj Kuvendi me vendim. Kjo edhe për faktin se praktika po dëshmon se këto agjencione kanë kërkesa të larta, sidomos për paga.

Haki Shatri, hapi diskutim rreth nenit 7.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, theksoi se me këtë nen është menduar që të ndikohet të organizatat buxhetore të bëjnë planifikim më të saktë të buxhetit të tyre. Arsyeja qëndron në atë se ato kërkojnë mjete duke mos i detalizuar projektet. Prandaj me këtë nen ato që nuk i kanë shpenzuar mjetet i kanë dy mundësi, njëra që ti shpenzojnë ato që nuk i kanë shpenzuar në vitin vijues dhe e dyta të marrin mjete shtesë në bazë të prezantimit të projekteve të detalizuara mirë.

Besa Gaxherri, kërkoi që të ndikohet në këto organizata që të respektojnë periudhën njëvjeçare të realizimit buxhetor.

Kosara Nikolic, pyeti qfarë bëhet nëse projekti për shkaqe teknike nuk realizohet brenda vitit?

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, nëse për shkaqe teknike nuk realizohet, mjetet i barten organizatës për në vitin vijues, nëse prezanton projekte të realizueshme.

Haki Shatri, pyeti pse shujta dhe shpenzimet e udhëtimit nuk janë përfshirë në kategorinë mallra dhe shërbime. Ato duhet përjashtuar nga tatimimi prandaj nuk duhet mbetur në kategorinë paga dhe mëditje. Propozoi që termi “shtesa” të zëvendësohet me termin “mëditje”.

Agim Krasniqi, për shkak të kritikave që kemi pasur ato janë përfshirë në kategorinë paga dhe mëditje.

Besa Gaxherri, pyeti se a janë paraparë shumat në emër të eksproprijimit si zë i veçantë buxhetor apo janë përfshirë në kuadër të shumës totale të projekteve të organizatave buxhetore.

Ahmet Shala, Ministër i MEF-it, me përjashtim të autostradave që janë paraparë si zë i veçantë buxhetor, në projektet tjera janë përfshirë në shumat e tyre totale.

Riza Smaka, shumat e ekproprijimit do të duhet të përcaktohej me Ligjin për eksproprijimit e jo të përfshihen në projektet përkatëse.

U diskutua rreth nenit 10.4, mbeti që z. Smaka së bashku me përfaqësuesit e MEF-it të sjellin një formulim i cili do të diskutohet në Komision.

Neni 11.1 u propozua të ndryshohet shifra nga “20%” në “15 %” si dhe të riformulohet fjalia e fundit, testin e së cilit do ta sjellin përfaqësuesit e MEF-it, i cili do të diskutohet në Komision.

Neni 11.3, u diskutua për mbylljen e avanceve.

Safete Hadërgjonaj, kërkoi që me Ligj të parashihet mbyllja e avanceve brenda afatit prej 15 ditëve. Pas kalimit të këtij afati të parashifet aplikimi i ndëshkimit në zbritjen e mjeteve nga paga

ndaj atyre që nuk mbyllin avancet.

Pas diskutimeve, u votua që paragrafi 3 i nenit 13 të fshihet.

Neni 12 u diskutua për mundësinë që ministri të jetë i autorizuar nga Qeveria që të lejojë shpenzimin nga shpenzimet e paparashikuara deri në një vlerë të caktuar, e cila shumë do të kufizohet se sa mund të bëhet brenda vitit. (U përkrash ideja që të krijohet një paragraf të ri me tekstin që do të sjellin përfaqësuesit e MEF-it, i cili do të diskutohet në Komision).

Neni 14 u diskutuat rreth mundësisë së dhënies së lejes së ministrit për lëvizjen e mjeteve kapitale prej një projekti kapital në tjetrin projekt kapital brenda programit të njëjtë të asaj organizate buxhetore, duke përcaktuar kufizimet. U propozua që të riformulohet i gjithë neni nga përfaqësuesit e MEF-it, i cili mëpastaj do të diskutohet në Komision.

Neni 15, pati disa propozime. Mbeti që të diskutohet në mbledhjen e radhës.

Haki Shatri, duke komentuar nenin 16, theksoi se duhet analizuar këtë nen dhe në mbledhjet në vazhdim të bëhen propozime më të qarta dhe më të pranueshme, sepse ashtu siç është formuluar nuk mund të kalojë në seancë.

Neni 16 mbeti të diskutohet në mbledhjet e ardhshme.

Myrvete Pantina, kërkoi që të shtohet një nen që rregullon çështjen e subvencionimit të ndërmarrjeve publike.

Riza Smaka, kërkoi që edhe neni 18 të riformulohet.

3. Të ndryshme

Nuk pati ndonjë çështje për tu diskutuar.

Mbledhja përfundoi në ora 13:30

Përgatitur nga
Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesi i Komisionit,

Haki SHATRI